



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHITJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

# Pasqyra krahasuese e Kodeve të Sjelljes Etike të Deputetëve (përvojat ndërkombëtare)



Имплементирано од:





ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMMI PER MBESHETETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

## IMPRESUM:

Titull: Pasqyra krahasuese e Kodeve të Sjelljes Etike të Deputetëve  
(përvojat ndërkombëtare)

Botues: Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN)

Rreth botuesit: Drejtoreshë Ekzekutive e QMN-së, Neda Maleska Saçmaroska

Autor: Ekipi i QMN-së

Redaktor: Neda Maleska Saçmaroska

Dizajni: Marko Danailovski

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА  
PROGRAMI PËR MBËSHTETJE PARLAMENTARE  
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

Ky dokument është hartuar në kuadër të Programit të Mbështetjes Parlamentare (PSP), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes Ambasadës Zvicerane në Republikën e Maqedonisë së Veriut. PSP-ja zbatohet nga Instituti Demokratik Nacional (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup (IDSCSH) dhe Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMN). Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e SDC-së.





## 1. HYRJE

Instituti Demokratik Nacional (NDI) brenda Programit të Mbështetjes Parlamentare (PSP), ndërsa në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup dhe ODIHR-në, i siguron mbështetje Kuvendit në përpjekjet për të ndërtuar besueshmërinë institucionale dhe besimin publik duke përfaqësuar interesat dhe nevojat e qytetarëve dhe debatin gjithëpërfshirës dhe të orientuar në mënyrë konsensuale në procesin e miratimit të vendimeve. Në vigjilje të raportit të ardhshëm të GREKO-s që pritet në shtator 2021, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me mbështetjen e NDI-së, Misionit të OSBE-së në Shkup dhe ODIHR-së, filloi procesin e revidimit të Udhëzimit për zbatimin e Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve. Në përputhje me vërejtjet e GREKO-s, por edhe në përputhje me rekomandimet e ekspertëve të ODIHR-së, është e domosdoshme të forcohet më tej Udhëzimi për zbatimin e Kodit Etik në drejtim të sigurimit të zbatimit të tij të plotë. Procesi i revizionit të Udhëzimit, e ngriti edhe çështjen e nevojave për revizionin edhe të Kodit ekzistues të Sjelljes Etike të Deputetëve në Kuvendin e RMV-së në drejtim të forcimit të tij dhe të harmonizimit me praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.

Kjo pasqyrë krahasuese është një nga dokumentet për mbështetjen e procesit të përmendur të revidimit të Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve dhe Udhëzimit për zbatimin e Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve në Kuvendin e RMV-së. Pasqyra mundëson, përmes prezantimit të Kodeve të Sjelljes Etike të Deputetëve në disa vende, të identifikohen fushat që mungojnë në Kodin e Sjelljes Etike të Deputetëve në Kuvendin e RMV-së, si dhe të përcaktohen rekomandimet për zgjerimin dhe forcimin e kodit ekzistues për të inkurajuar zbatimin e tij të plotë, por edhe për të kontribuar në forcimin e besimit në Kuvend nga qytetarët. Pasqyra krahasuese i përfshin këto vende: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britaninë e Madhe, Shqipërinë, Gjeorgjinë dhe Maltën.

Pasqyra i referohet edhe Kodit aktual të Sjelljes së Deputetëve në RMV krahasuar me Kodet e Sjelljes Etike të Deputetëve nga vendet e zgjedhura. Qëllimi i pasqyrës bazohet në praktikën më të mira ndërkombëtare, për të propozuar një sërë rekomandimesh për përmirësimin e dokumenteve që rregullojnë fushëveprimin e sjelljes etike dhe sjelljes së deputetëve në vendin tonë.

## 2. QËLLIMI I KODEVE TË SJELLJES ETIKE

Përveç ndërtimit të institucioneve demokratike, me rëndësi thelbësore për suksesin e një vendi është që bartësit e funksioneve në ato institucione t'u përmbahen standardeve të caktuara profesionale dhe etike. Kjo vlen edhe për demokracitë e pjekura dhe për ato ku institucionet demokratike janë akoma "në fazën e ndërtimit". Në botë, por edhe në rajon, ekziston konsensus në rritje për forcimin e standardeve profesionale dhe etike për deputetët, të cilat janë thelbësore për forcimin e menaxhimit të mirë, integritetit publik dhe sundimit të së drejtës.



Një nga aspektet më të rëndësishme kur bëhet fjalë për zbatimin e Kodeve të Sjelljes Etike është njohuria se me rëndësi të paçmueshme është vetëdija dhe informacioni i deputetëve që aktivitetet dhe vendimet e tyre profesionale kanë dimension të fortë etik dhe se ata duhet t'i ndjekin normat e përcaktuara etike në punën e tyre dhe të praktikojnë sjellje të pranueshme dhe të pritshme në kryerjen e punës.

Bazuar në këto njohuri dhe duke pasur parasysh se menaxhimi i mirë është me rëndësi thelbësore për funksionimin efikas të demokracisë, veçanërisht në trupat përfaqësuese nacionale, Asambleja Parlamentare e OSBE-së në Deklaratën e saj të Brukselit për vitin 2006 i inkurajoi të gjitha parlamentet që:

- të zhvillojnë dhe publikojnë standarde rigorozet e etikës dhe sjelljes zyrtare për parlamentarët dhe shërbimet e Kuvendit;
- të vendosin mekanizma efikase për njoftimin publik të informacioneve financiare dhe konfliktit të mundshëm të interesave të deputetëve; dhe
- të vendosin zyrë për standardet në të cilën do të paraqiteshin shkeljet e standardeve të deputetëve.

Vendosja dhe zbatimi i standardeve dhe mekanizmave të tillë është urë midis ndërtimit të institucioneve demokratike dhe vendosjes së kulturës politike demokratike.

Në fakt, qëllimi i drejtpërdrejtë i Kodeve të Sjelljes Etike nuk është vetëm promovimi i standardeve etike dhe sjellja e dëshirueshme në jetën publike, por është edhe mjet i fuqishëm në duart e deputetëve për:

- Luftën kundër korrupsionit - Standardet e forta dhe rregullativa mund të ndihmojnë në parandalimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe formave të tjera të korrupsionit përmes: vendosjes së rregullave të qarta mbi faktin se si duhet të sillen deputetët, ndjekja e sjelljes dhe shfaqja e indinjatës publike dhe dënimi i shkeljeve të kodit. Duke pasur parasysh se roli i deputetit është kompleks, dhe mund të ngrejë numër të madh dilemash etike, me rëndësi të paçmueshme është ekzistimi i standardeve të qarta dhe të sakta për veprimin dhe sjelljen e deputetëve.
- Forcimin e përgjegjësisë dhe besimit - Standardet e qarta etike e përmirësojnë përgjegjësinë përmes sigurimit të përcaktuesve të qartë për publikun dhe mediat, sipas të cilave, duhet të ndjekin dhe vlerësojnë sjelljen e deputetëve. Nëse qytetarët besojnë se sistemi për rregullimin e etikës është i drejtë dhe efektiv, atëherë është më lehtë për ta të ndërtojnë besim në Kuvend, i cili ka shprehur angazhim të fortë për zbatimin e këtyre standardeve në punën e tij;
- Profesionalizimin e politikës - Historikisht, deputetët e zgjedhur në Kuvend janë me prejardhje dhe profesione të ndryshme, gjë që është shumë e rëndësishme për demokracinë përfaqësuese. Si në çdo profesion tjetër, edhe për bartësit e funksioneve publike, në këtë rast për deputetët, zbatohen rregullat dhe standardet për veprim dhe sjellje si deontologji specifike në këtë fushë. Përveç kësaj, standardet e qarta dhe të sakta ndihmojnë deputetët të bashkohen rreth interesit publik dhe qëllimeve të përbashkëta për progres dhe zhvillim, duke u mundësuar tejkalimin e dallimeve politike natyrore dhe ndërtimin e ndjenjës së kolegjalitetit dhe mirëkuptimit; dhe



- Përmeshjen e standardeve ndërkombëtare - Futja e Kodeve të Sjelljes Etike për bartësit e funksioneve publike, përfshirë edhe deputetët, duke promovuar integritetin, sinqeritetin dhe përgjegjësinë, gjithashtu e shfaq përkushtimin e shtetit për të zbatuar dhe respektuar standardet dhe normat e përbashkëta ndërkombëtare.

Për këto arsye, shumë parlamente vazhdimisht përpiqen t'i reformojnë standardet profesionale dhe etike dhe të miratojnë një sërë normash të specializuara, që janë thelbësore për rolin e deputetëve. Nuk ka zgjidhje dhe formë të vetme për përmirësimin e standardeve etike parlamentare, por përvojat ndërkombëtare tregojnë se strategjitë më efektive janë ato që i marrin parasysh kushtet politike dhe institucionale specifike dhe i përshtatin standardet me situatën aktuale.

### 3. FORMA DHE PËRMBAJTJA E KODEVE TË SJELLJES ETIKE - PASQYRA KRAHASUESE

Kodet e Sjelljes Etike të Deputetëve pretendojnë t'i përcaktojnë parimet dhe vlerat themelore etike që deputetët i zbatojnë në kryerjen e detyrave të tyre dhe në sjellje. Qëllimi i secilit kod është përmes një sërë normash të shprehura në të për të siguruar kornizë dhe standarde për sjelljen e deputetëve, në të njëjtën kohë duke ndërtuar sistemin e besimit nga publiku përmes integritetit të tij personal dhe integritetit të institucionit që e përfaqësojnë.

Kodet e Sjelljes Etike të Deputetëve shpesh shoqërohen me Udhëzime për zbatimin e Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve të cilat synojnë të ofrojnë shpjegime të dispozitave të përcaktuara në kodet, si dhe të japin shembuj konkretë të asaj që konsiderohet sjellje e dëshirueshme dhe e aprovuar, ndërsa është e padëshiruar dhe e dënuar. Udhëzimi është mjet që duhet t'u shërbejë deputetëve për të vlerësuar me lehtësi dhe saktësi se si të veprojnë në rastet kur përballen me dilemë të caktuar morale.

Në vazhdim janë paraqitur praktikat më të mira ndërkombëtare në rregullimin e fushës së veprimit dhe sjelljes etike të deputetëve, në mënyrë që të shërbejnë për krijimin e rekomandimeve të mira për forcimin e sistemit të sjelljes etike të deputetëve në vendin tonë.

#### 3.1 SHBA

- *Forma dhe struktura e Kodit*

Kodi i Sjelljes së Anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit të SHBA-së u miratua nga Komiteti për Standardet e Sjelljes. Ka formën e aktit të përgjithshëm, përkatësisht nuk ka dimension ligjor. Dokumenti është shkruar në formën e Doracakut me 10 kapituj në të cilat paraqiten parimet dhe standardet e veprimit dhe sjelljes etike, por në të njëjtën kohë ofrohen edhe udhëzime dhe drejtime për zbatimin e tyre me shembuj konkretë në secilën fushë. Doracaku është i vëllimshëm dhe përmban një numër të madh shembujsh që synojnë të ndihmojnë kongresmenët në situatën e ekzistimit të dilemave morale në ndonjë procedurë.



Ekziston edhe një dokument më i shkurtër që është sublimat i pikave më të rëndësishme dhe rregullave dhe standardeve të përcaktuara të sjelljes të destinuara për deputetët.

- *Fushat të cilat përpunohen në Kod*

Kodi i Sjelljes së Deputetëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës përmban 10 kapituj që trajtojnë në detaje fusha të ndryshme të sjelljes së deputetëve që shpjegohen me shembuj të shumtë. Kapitulli i parë i vështron standardet e përgjithshme etike të cilave duhet t'u përmbahen deputetët. Kjo pjesë i përfshin fushat që kanë të bëjnë me shkeljet e standardeve etike, historikun dhe procedurat e Komitetit, rregullat e sjelljes së deputetëve dhe nëpunësve. Kjo pjesë, gjithashtu, i shpjegon procedurat për t'u përmbajtur nga aktiviteti legjislativ pas dënimit dhe procedurat për ofrimin e mendimeve këshillëdhënëse.

Kapitulli i dytë "Dhuratat" është më i vëllimshëm dhe ofron pasqyrë të temave të përpunuara në detaje në lidhje me rregullat e pranimit dhe menaxhimit të dhuratave. Në këtë pjesë është dhënë vështrimi mbi ndalimet dhe historikun e rregullave të pranimit të dhuratave. Të gjitha temat në këtë kapitull shpjegohen me shembuj konkretë të sjelljes së pranueshme ose të papranueshme. Kapitulli "Dhuratat" përfshin fushat që lidhen me: dispozitat e përgjithshme për dhuratat e pranueshme, dhuratat e dhëna në bazë të miqësisë personale dhe ftesat për të marrë pjesë në evenimente. Pastaj jepet shpjegimi për pranimin e dhuratave në përputhje me vlerën nominale të dhuratës dhe saktësimin se cilat janë artikujt e protokollit si dhurata të pranueshme. Brenda kësaj pjese janë përpunuar posaçërisht temat për: gjërat e paguara nga qeveria federale ose ndonjë shtet ose vetëqeverisja lokale dhe dhuratat nga qeveritë e huaja dhe organizatat ndërkombëtare. Kapitulli "Dhuratat", gjithashtu, përfshin edhe përfitimet që dalin nga biznesi i jashtëm. Aspekte veçanërisht të rëndësishme u referohen dhuratave nga të afërmit, deputetët e tjerë, nëpunësit ose të punësuarit, çmimet, donacionet, veprat artistike dhe dhuratat e tjera të natyrës së pazakontë. Shpjegohen edhe rregullat për trajtimin e dhuratave të papranueshme dhe kthimin e dhuratave.

Kapitulli i tretë "Udhëtimet" jep një pasqyrë të përgjithshme dhe rregullat e udhëtimeve të lejuara të deputetëve dhe nëpunësve të tjerë. Në këtë kapitull, gjithashtu, temat janë përpunuar në detaje me shembujt konkretë të dhënë në secilën fushë. Rregullat në këtë kapitull u referohen: udhëtimeve zyrtare të paguara nga burimi privat, udhëtimeve që nuk lidhen me detyrat zyrtare të paguara nga burimi privat, udhëtimeve të paguara nga qeveria federale ose pushteti shtetëror ose lokal, udhëtimeve të paguara nga qeveria e huaj, udhëtimeve të paguara nga organizata politike, udhëtimeve në dedikimin e përzier dhe udhëtimin në evenimente bamirëse. Në mënyrë plotësuese, këto fusha përfshijnë tema në lidhje me udhëtimet e sponsorizuara nga lobistët ose agjentët e huaj, qëllimet e udhëtimit, shoqërimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e pranueshme të udhëtimit, miratimi nga Komiteti i Standardeve dhe regjistrimi i udhëtimit.

Kapitulli i katërt "Fushatat" përqendrohet në ligjet, rregullat dhe standardet e katër temave kryesore në lidhje me pjesëmarrjen e deputetëve në fushatë dhe aktivitetin politik, të tilla si:

- Ndalimi i përgjithshëm i përdorimit të burimeve zyrtare për nevojat e fushatës ose qëllimeve politike;
- Rregullat për angazhimin e deputetëve në fushatë (jashtë orarit të punës, jashtë zyrave të Kongresit dhe pa përdorimin e burimeve zyrtare);
- Kërkesa dhe pranimi i kontributeve të fushatës; dhe
- Përdorimi i duhur i mjeteve të fushatës.



Kapitulli 5 "Të ardhurat e jashtme dhe punësimi" ofron pasqyrë të plotë të ligjeve, rregullave dhe standardeve të sjelljes që rregullojnë punësimin e jashtëm të deputetëve. Ky kapitull përfshin kufizimet në punësimin dhe të ardhurat e jashtme të nëpunësve të punësuar, si dhe kufizimet në punësimin e jashtëm që zbatohen për deputetët dhe personalin senior. Kjo pjesë i shpjegon të ardhurat e lejuara dhe të kufizuara nga fitimi i jashtëm për deputetët dhe personalin senior. Në mënyrë plotësuese, është përfshirë fusha e votimit të deputetëve për çështjet me interes personal. Si tema të veçanta që përpunohen janë kufizimet në punësimin e deputetëve dhe punësimin e bashkëshortëve / bashkëshorteve të deputetëve.

Kapitulli 6 "Deklaratat financiare" synon të sigurojë pasqyrë themelore të obligimeve për paraqitjen e pronës dhe mjeteve financiare nga deputetët dhe nëpunësit. Çdo vit, Komiteti i Standardeve boton broshura gjithëpërfshirëse me udhëzime për plotësimin e Deklaratës së Zbulimit Financiar. Ky kapitull rregullon dhe shpjegon rregullat që rregullojnë deklarimin e interesave financiare; paraqitjet për deklarimin themelor dhe specifik të interesave; afatet për parashtrimin, qasjen e publikut në raportet dhe procedurën për mosparaqitjen ose parashtrimin e deklaratave të rrejtshme.

Kapitulli "Të drejtat dhe obligimet e deputetëve" ofron pasqyrë të qartë të rregullave specifike të miratuara që rregullojnë marrëdhënien e punës në Kongres. Kjo pjesë i përfshin temat, të tilla si diskriminimi, nepotizmi, praktikat e paligjshme të punësimit dhe largimi nga puna. Pastaj përcaktohen trajnimet e etikës të ofruara për deputetët dhe të punësuarit e tjerë në nivel vjetor. Shpjegohen, gjithashtu, mundësitë për angazhimin e vullnetarëve, praktikantëve, bashkëpunëtorëve dhe konsulentëve.

Kapitulli 8 "Puna në rastin / projektin" i përpunon informacionet në të cilat deputeti ka qasje, mundësitë për të vendosur kontakte dhe për të caktuar takime me gjykatat, qeveritë e tjera dhe organizatat joqeveritare. Në mënyrë plotësuese, diskutohet mbi mundësinë që deputeti të kërkojë informacione ose raporte për statusin e ndonjë lënde të caktuar dhe të kërkojë rishqyrtim, bazuar në ligj dhe rregullativë, ose vendime të tjera. Ky kapitull vështron, gjithashtu, ndalimin e pranimit të dhuratave të ofruara në lidhje me ose në kthim për marrjen e aktiviteteve dhe dhënien e udhëzimeve dhe rekomandimeve për punësim.

Kapitulli 9 "Shtesat zyrtare" i përshkruan shtesat e përfaqësimit të anëtarëve të Kongresit që u takojnë për kryerjen e detyrave zyrtare në fushën në të cilën janë zgjedhur. Ky kapitull ofron një pasqyrë të autorizimeve ligjore për kompensimet e tilla të shpenzimeve. Në mënyrë plotësuese, shpjegohen situatat e mundshme që shkaktojnë dilema kur përdoren këto shtesa për shpenzimet zyrtare dhe rrethanat kur përdoren për nevoja personale ose në fushatë.

Kapitulli i fundit, "Organizatave zyrtare dhe të jashtme", i përfshin standardet që deputetët dhe të punësuarit duhet t'i respektojnë në lidhje me aktivitetet që i vendosin me organizatat që i mbështesin në kryerjen e funksionit të tyre. Kapitulli përqendrohet, gjithashtu, në kufizimet e bashkëpunimit me entitetet private ose "të jashtme". Në kuadër të këtij kapitulli është bërë një pasqyrë e organizatave zyrtare të mbështetjes, subjekteve private me qëllime të përbashkëta, grupeve këshillëdhënëse të anëtarëve etj. Një pjesë e fokusit është vënë në nevojën që qartë të bëhet distinkcioni midis aktiviteteve zyrtare të Kongresit dhe aktiviteteve jashtë Kongresit në të cilat deputeti merr pjesë, si dhe rregullat që deputetët t'i përdorin resurset zyrtare për qëllime private.





## 3.2 Mbretëria e Bashkuar

### - Forma dhe struktura e Kodit

Kodi i Sjelljes Etike të Deputetëve të Mbretërisë së Bashkuar miratohet nga Dhoma e Poshtme e Parlamentit. Ngjashëm si edhe Kodi i Deputetëve të SHBA-së, dokumenti nuk ka dimension ligjor, përkatësisht ka formën e Doracakut. Dokumenti është përmbledhje e Kodit dhe Udhëzimeve për zbatimin e Kodit. Kodi përfshin qëllimin e Kodit, fushën e tij, detyrat e deputetëve, parimet e përgjithshme, rregullat e sjelljes dhe obligimin për të respektuar Kodin. Në Udhëzimin për zbatimin e Kodit shpjegohen në detaje rregullat për sjelljen e deputetëve.

### - Fushat të cilat përpunohen në Kod

Kodi i Sjelljes së Deputetëve të Britanisë së Madhe i hartuar së bashku me Udhëzuesin për Rregullat e Sjelljes së Deputetëve dhe Shtojcën e Udhëzuesit të Rregullave: Rezolutat e Dhomës në lidhje me sjelljen e deputetëve.

Kodi i Sjelljes së Deputetëve ofron një sërë rregullash që deputetët duhet t'u përmbahen. Në kuadër të Kodit ka vështrim mbi qëllimin dhe fushën e Kodit, detyrat e deputetëve në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të punës, parimet e përgjithshme dhe rregullat e sjelljes të dhëna në formën e detyrave, si dhe kompetencat e Komitetit të Standardeve dhe të Autorizuarit Parlamentar të Standardeve për ndjekjen e respektimit të rregullave të Kodit.

Udhëzuesi për Sjelljen e Deputetëve përmban 4 kapituj që përqendrohen në fusha të ndryshme të sjelljes së deputetëve. Udhëzuesi, gjithashtu, e përcakton procedurën për zbatimin e hetimeve nga i Autorizuari Parlamentar i Standardeve. Kapitulli i parë dhe i dytë "Regjistrimi i interesave financiare të deputetëve" mbulojnë përmbushjen me ndërjegje të kërkesave të Dhomës në lidhje me regjistrimin e interesave në Regjistrin e Interesave Financiare të Deputetëve. Kapitulli 1 shpjegon kushtet në lidhje me regjistrimin e interesave financiare të deputetëve; Kapitulli 2 shpjegon kërkesat në lidhje me paraqitjen e interesave në rrethana të tjera. Dy kapitujt e parë përfshijnë dispozita në lidhje me qëllimin e regjistrimit dhe deklaratën e interesave, sigurimin e informacioneve mbi interesat financiare relevante të deputetëve, publikimin dhe ruajtjen e të dhënave në Regjistër dhe kategoritë e informacioneve financiare që deputetët duhet t'i regjistrojnë. Kjo pjesë përfshin, gjithashtu, të gjitha interesat që mund të regjistrohen, interesat e tjerë financiarë që i përmbushin kërkesat e testit të rëndësisë, por për të cilat nuk është i nevojshëm regjistrimi, përfshirë interesat e së kaluarës dhe interesat e pritshëm në të ardhmen, si dhe interesat financiare indirekte të bashkëshortit / bashkëshortes, partnerit ose anëtarit të familjes, interesat jofinanciare, etj.

Kategoritë që janë përpunuar në kapitullin e parë "Regjistrimi i interesave financiare të deputetëve" janë si vijon:



- Punësimi dhe fitimi;
- Donacionet dhe mbështetja tjetër për aktivitetet e kryera në cilësinë e deputetit;
- Dhuratat, përfitimet dhe shërbimet hotelierike nga burimet në Mbretërinë e Bashkuar;
- Vizitat jashtë Mbretërisë së Bashkuar;
- Dhuratat dhe përfitimet nga burimet jashtë Mbretërisë së Bashkuar;
- Toka dhe prona;
- Pjesëmarrjet e aksionarëve;
- Të ndryshme;
- Punësimi i anëtarëve të familjes;
- Anëtarët e familjes të përfshirë në lobim.

Kategoritë që janë përpunuar në kapitullin e dytë "Deklarata e interesave të deputetëve" janë si vijon:

- Kërkesat për deklaratën e interesave;
- Rastet kur është e nevojshme të parashtrahet deklarata e interesave.

Kapitulli i tretë "Lobimi për shpërblim ose kompensim" përcakton kufizimet e deputetëve për të lobuar për shpërblim ose kompensim. Kjo pjesë i vështron rregullat në lidhje me lobimin dhe kufizimet e deputetëve dhe kufizimet kohore në përputhje me rregullat për lobim. Tema e fundit e kësaj pjese i referohet zbatimit të rregullave të lobimit.

Kapitulli 4 "Procedura e hetimeve" ofron pasqyrë të kompetencave të të autorizuarit dhe përcaktohen procedurat në lidhje me hetimet e të autorizuarit. Ky kapitull i përpunon kërkesat e Dhomës të cilat përfshijnë situata në të cilat mund të fillohet procesi i hetimit. Jepet shpjegimi për procedurat e parashtrimit të ankesës, kushtet për privilegjin parlamentar, si dhe proceset e fillimit të hetimit. Kjo pjesë i shpjegon procedurat dhe rolin e të Autorizuarit Parlamentar të Standardeve dhe Komitetin e Standardeve në zgjidhjen e hetimeve. Ky kapitull, gjithashtu, shpjegon kompetencën e të Autorizuarit Parlamentar të Standardeve.

Në pjesën e fundit "Shtesa në Udhëzuesin e Rregullave", jepen shembuj dhe shpjegime të Rezolutave të miratuara nga Parlamenti në lidhje me sjelljen e deputetëve që u referohen temave si vijon:

- Regjistrimi dhe paraqitja e interesave financiare të deputetëve;
- Lobimi për shpërblim ose kompensim;
- Sjellja e deputetëve.



### 3.3 SHQIPËRIA

#### - *Forma dhe struktura e Kodit*

Kodi i Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë u miratua me propozimin e grupit parlamentar në bazë të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Kodi ka formën e dokumentit ligjor të nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit, në të cilin në kapituj të veçantë që përmbajnë nene, paragrafë dhe aline theksohen parimet dhe principet themelore etike, normat dhe rregullat e sjelljes së pritshme dhe mekanizmat për ndjekjen dhe evalvimin e zbatimit të Kodit. Kodi është pjesë e Rregullores së Punës së Kuvendit të dhënë në Aneksin 2 të Rregullores.

#### - *Fushat të cilat përpunohen në Kod*

Kodi i Sjelljes së Deputetëve të Republikës së Shqipërisë përmban 6 kapituj që përqendrohen në fusha të ndryshme të sjelljes së deputetëve, me përjashtim të kapitullit të fundit. Kapitulli i parë e vështron qëllimin dhe zbatimin e Kodit, parimet themelore etike të dhëna në formën e detyrave, si dhe obligimet e deputetit në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë.

Kapitulli i dytë "Sjellja në Kuvend" përfshin sjelljen e pritshme dhe të dëshiruar të deputetëve. Kjo pjesë përmban dispozita në lidhje me ndalimin e përdorimit të fjalorit joparlamentar, ofendues, të pahijshëm që shkakton ose nxit urrejtje, si dhe përdorimin e fjalorit diskriminues dhe stereotipizimin në çfarëdo baze. Njohet ndalimi i votimit në emër të të tjerëve nga deputeti, si dhe standardet për veshjen e denjë dhe mbajtjen e rendit dhe disiplinës në Kuvend. Theksohen edhe rregullat për përdorimin e resurseve të Kuvendit, duke përfshirë edhe përdorimin e shërbimeve parlamentare me vëmendje të veçantë për respektimin e paanësisë së tyre. Theksohet ndalimi për shqetësimin seksual, si dhe mënyrat e fjalimit të sjellshëm që pritet nga deputetët. Kjo pjesë, gjithashtu, vë në dukje edhe obligimin e deputetëve për t'i ndjekur aktivitetet për orientim, këshillim dhe shkëmbim të përvojave, veçanërisht në fillim të mandatit të tyre.

Në pjesën e tretë "Konflikti i interesave dhe deklarata dhe kontrolli i situatës së pronës" që njëherazi është edhe më i vëllimshmi përkufizohet konflikti i interesave, deklarata e konfliktit të interesave që deputeti e jep përpara çdo diskutimi plenar, ndërsa për të cilat deklarata Kuvendi mban Regjistër të veçantë dhe vë në dukje ndalimin që deputeti të votojë për Propozim-ligjin që është përcaktuar se ka konflikt të interesave. Kjo pjesë, gjithashtu, i referohet rregullativës në lidhje me kontrollin e gjendjes pronësore të deputetëve dhe mënyrën e publikimit të deklaratave të gjendjes pronësore. Gjithashtu, përsëriten edhe kufizimet e deputetëve gjatë kryerjes së mandatit nga aspekti i papajtueshmërisë së funksionit me funksionet e tjera shtetërore, organet drejtuese, aktivitetet private që bëjnë fitim, pjesëmarrjet e aksionarëve, etj., si dhe kohëzgjatja e kufizimeve të përmendura. Bëhet edhe reflektimi i legjislacionit aktual i cili rregullon imunitetin e deputetëve dhe përcakton se çfarë nënkuptohet me nocionin aktivitete jashtëparlamentare që u lejohen deputetëve. Kjo pjesë përcakton rregulla në lidhje me marrëdhëniet e deputetit me lobistët dhe organizatat civile ose grupet e interesit, si dhe vendosja e regjistrimit të lobimit, grupeve të interesit dhe organizatave civile që e mban Kuvendi, në të cilin deputetët i paraqesin takimet me lobistët dhe organizatat e lobit. Tema e fundit e kësaj pjese ka të bëjë me pranimin e dhuratave nga deputetët, përkatësisht ndalimin e pranimit të dhuratave, dhuratat e lejuara të protokollit, mënyra e paraqitjes dhe regjistrimit të tyre, si dhe veprimi me dhuratat.



Pjesa e katërt i referohet "Transparencës dhe mbrojtjes së informacioneve" e cila mbulon transparencën e deputetit në komunikimin me votuesit, publikun dhe mediat në lidhje me aktivitetet parlamentare, publikimin e gjendjes pronësore dhe shpenzimeve financiare në kryerjen e funksionit, si dhe transparencën e Kuvendit për projektet e financuara nga donatorët e jashtëm që zbatohen. Kjo pjesë, gjithashtu, i përfshin edhe obligimet për të mbajtur informacionet e klasifikuara, si dhe kufizimet që deputetët i kanë në karrierën e tyre të ardhshme ose angazhimet e punës pas përfundimit të mandatit të tyre.

Pjesa e pestë "Evalvimi dhe interpretimi i Kodit të Sjelljes" përcakton vlerësimin dhe pasqyrën periodike të Kodit, ndikimin e standardeve në punën politike të deputetëve, nevojën për revizionin e Kodit, si dhe procesin e evalvimit të kryer në procesin gjithëpërfshirës me përfshirjen e organizatave civile dhe grupeve të interesit që bashkëpunojnë ngushtë me Kuvendin. Përcaktohet edhe trupi kompetent për interpretimin e Kodit - Këshilli për Rregullimin, Mandatet dhe Imunitetin.

Pjesa e fundit u referohet dispozitave kalimtare dhe të fundit dhe kjo pjesë nuk përmban standarde dhe rregulla të sjelljes, por e përcakton infrastrukturën e nevojshme informatike të nevojshme për të siguruar transparencë, e cakton kompetencën për të zbatuar Kodin në Byronë e Kuvendit dhe e përcakton Udhëzimin për zbatimin e Kodit të Sjelljes si dokument të veçantë.

### 3.4 GJEORGJIA

#### - *Forma dhe struktura e Kodit*

Kodi i Sjelljes së Deputetëve të Parlamentit të Gjeorgjisë është dokument i miratuar nga Parlamenti. Dokumenti ka formën e aktit juridik i cili në nene i përcakton parimet themelore etike, rregullat e veprimit dhe sjelljes së deputetëve dhe mekanizmat për ndjekjen dhe evalvimin e zbatimit të Kodit. Kodi shoqërohet me disa dokumente: Rregulloren e Punës së Këshillit të Etikës, deklaratën e konfliktit të interesave, formularin e ankesës për shkeljen e Kodit dhe formën e Regjistrimit të Dhuratave.

#### - *Fushat të cilat përpunohen në Kod*

Kodi i Sjelljes së Deputetëve në Gjeorgji është Preambulë e hartuar në të cilën arsyetohet qëllimi i Kodit dhe 6 nenet që i përfshijnë parimet themelore, rregullat e sjelljes dhe mekanizmat për ndjekjen dhe evalvimin e zbatimit të Kodit. Neni i parë i referohet "Fushës së zbatimit të Kodit", përkatësisht që përcaktohet nga Kodi dhe cila është baza juridike e miratimit të tij. Neni i dytë përfshin shpjegime të parimeve themelore të Kodit: ligjitimiteti dhe besnikëria, barazia, ndershmëria, llogaridhënia, transparenca dhe përgjegjësia.



Neni i tretë u referohet rregullave të sjelljes së deputetëve. Në këtë pjesë theksohen rregullat për sjelljen etike dhe të ndërgjegjshme të deputetëve në kryerjen e funksionit, siç janë ndalimi i pranimit të dhuratave, ndalimi i pranimit të dhuratave nga lobistët dhe personat, qëllimi i të cilëve është të ndikojnë në kryerjen e funksionit të tij / të saj, paraqitja e dhuratave të pranuar në regjistrin e dhuratave. Rregullat rregullojnë procedurën e dhënies së deklaratave që paraqesin konflikt të interesave dhe deklaratave për pronën e deputetit. Në mënyrë plotësuese, neni 3 rregullon ndalimet për kryerjen e veprimtarive të caktuara të deputetit, të tilla si kryerja e veprimtarisë së sipërmarrjes, kryerja e aktiviteteve të lobimit, përdorimi i statusit dhe resurseve administrative për interesa personale, familjare ose partiake. Një pjesë e rregullave kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit ndaj kolegëve në bazë të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë ose bazave të tjera, si dhe përdorimin e gjuhës ofenduese, të vrazhdë, seksiste, diskriminuese, thirrjeve dhe veprimeve, si dhe çdo përdorim tjetër i gjuhës së urrejtjes. Sipas rregullave të sjelljes, deputeti nuk i keqpërdor informacionet që përmbajnë sekrete zyrtare ose informacione të tjera konfidenciale, të cilat i janë bërë të disponueshme gjatë kryerjes së funksionit.

Neni i katërt i rregullon mekanizmat për ndjekjen dhe zbatimin e rregullave. Ky nen i përfshin rastet e shkeljes së rregullave të sjelljes, rolin, të drejtat dhe obligimet e Këshillit të Etikës, si dhe rregullat për rekrutimin e anëtarëve të Këshillit të Etikës. Ky nen përshkruan procedurat për zgjedhjen e kryesuesve dhe bashkëkryesuesve të Këshillit të Etikës. Gjithashtu, neni e rregullon plotësimin dhe parashtrimin e formave të veçanta të ankesës për shkeljen e Kodit, procedurën e pranimit të ankesës dhe njoftimin e deputetëve. Fusha e dispozitave të këtij neni përshkruan procedurën e publikimit të emrave të anëtarëve të Parlamentit që kanë shkelur Kodin Etik. Në përputhje me dispozitat e këtij neni, anëtarët e Këshillit të Etikës dhe të punësuarit në Sekretariatit janë të detyruar t'i mbrojnë informacionet që përmbajnë sekrete zyrtare ose informacione të ndryshme konfidenciale që u janë bërë të disponueshme gjatë shqyrtimit të ankesës.

Neni 5 i Kodit informon se Parlamenti i Gjeorgjisë siguron trajnime për anëtarët për të prezantuar dispozitat dhe përmbajtjen e Kodit Etik.

Neni 6 përmban dispozitë kalimtare që e obligon Parlamentin në afat prej 1 muaji nga miratimi i Kodit të miratohet Rezolutë për formimin e Këshillit të Etikës.

### 3.5 MALTA

#### - Forma dhe struktura e Kodit

Kodi i Maltës, ngjashëm si Kodi Britanik, nuk ka formën e aktit ligjor, por të dokumentit në të cilin në disa nënpika janë dhënë parimet themelore të sjelljes etike dhe rregullat dhe standardet që deputetët duhet t'i ndjekin dhe t'i respektojnë në kryerjen e funksionit. Dokumenti u miratua nga Parlamenti i Maltës, përkatësisht nga Kryetari i Kuvendit qysh në vitin 1995. Në vitin 2020, është bërë analiza dhe revizioni nga komisionari për standarde në jetën publike dhe u propozua kod i ri i ndryshuar dhe i avancuar, si dhe Udhëzimi për zbatimin e tij të cilat nuk janë miratuar akoma formalisht.



#### - Fushat të cilat përpunohen në Kod

Kodi vendos standarde të sjelljes së duhur të propozuar nga anëtarët e Parlamentit si përfaqësues të zgjedhur që i shërbejnë vendit të tyre në institucionin e tij më të lartë demokratik. Në hyrjen theksohet se deputetët gjithnjë janë pritur të sillen në përputhje me dinjitetin e institucionit në të cilin shërbejnë, por që kodifikimi i rregullave dhe standardeve të sjelljes së deputetëve në Kod është mjet për pasqyrë më të mirë publike në punën e deputetëve dhe forcimin e përgjegjësisë së tyre ndaj qytetarëve. Kodi e vendos edhe Regjistrin e Interesave të Deputetëve dhe disponueshmërinë e tij publike.

Kodi është relativisht i shkurtër dhe përmban vetëm 6 pika, në 4 pikat e para janë të përfshira: veprimi dhe sjellja në mënyrën që e reflekton statusin dhe dinjitetin e Parlamentit; angazhimi për të vepruar në përputhje me Rregullat dhe Urdhrat e Parlamentit; ndalimi për të pranuar çfarëdo shpërblimi ose kompensimi për kryerjen e funksionit, përveç kompensimit të siguruar nga Parlamenti; angazhimi që deputeti në kryerjen e funksionit si përfaqësues i qytetarëve mos t'i nënshtrohet ndikimit, kërcënimeve ose presionit nga personat e tretë gjatë kryerjes së detyrave të tij. Pika e pestë vë në dukje obligimin e deputetëve për të paraqitur në nivel vjetor në Regjistrin e Interesave informacione në lidhje me profesionin e tyre dhe punëdhënësin, pronën e patundshme, si dhe pronën e bashkëshortit / bashkëshortes, mënyrën e fitimit të tij, aksionet në shoqëritë tregtare, investimet, duke i përfshirë edhe mjetet e depozituara në banka dhe çdo formë tjetër e kamatës monetare, funksionet e drejtorëve ose pozicionet e tjera zyrtare në kompanitë tregtare, shoqatat, këshillat, korporatat ose grupet e tjera, madje edhe nëse ato janë shoqata vullnetare. Paragrafi i dytë i së njëjtës pikë vë në dukje obligimin për të paraqitur interesat e deputetit, të tilla si: interesi profesional, duke përfshirë edhe shërbimet e këshillimit për punë, menaxhimi ose çfarëdo formë e lidhjes, formë monetare ose formë tjetër me personat, grupet ose kompanitë që kanë interes të drejtpërdrejtë në legjislacion, ndalimi i pranimit të dhuratave nga personat, grupet ose kompanitë që kanë ndonjë qëllim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të ndikuar në procesin legjislativ, ndalimi i pranimit të honorarit për të folur, shkruar ose botuar ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm nga ndonjë person, organizatë ose kompani që është më e madhe se vlera e zakonshme për shërbimet e tilla, ndalimi i pranimit të udhëtimit jashtë kufijve të Maltës dhe të financuar tërësisht ose pjesërisht nga personi, grupi ose kompania që kanë interes të drejtpërdrejtë në procesin legjislativ, si dhe pritjet e secilit anëtar të Parlamentit të njoftojë Kryetarin dhe organet kompetente për çdo përpjekje për korrupsion, presion ose ndikim të personave të tretë, që synojnë të ndikojnë në kryerjen e funksionit. Pika e fundit ka të bëjë me mosndërhyrjen e interesave profesionale ose të biznesit me funksionin që deputeti e kryen në Parlament, ndërsa në bazë të të cilit mund të fitojë përparësi në krahasim me subjektet e tjera në fushën e veprimit.

## 4. REKOMANDIMET

Pasqyra e vendeve të zgjedhura që zbatojnë Kodin e Sjelljes së deputetëve jep një pamje në fushën dhe përmbajtjen e kodeve në bazë të së cilave mund të formulohen rekomandimet për përmirësimin dhe avancimin e Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve në RMV dhe Udhëzimin për zbatimin e Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve në Kuvendin e RMV-së.



Kodit e Sjelljes Etike dhe rregullativa ligjore për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave janë elementet kryesore në ndërtimin e sistemeve të forta të integritetit. Në këtë mënyrë, ndërtohet në mënyrë sistematike kultura e intolerancës ndaj disa praktikave të dëmshme dhe joetike, zhvillohet konsensusi mbi atë që është veprim dhe sjellje etike, ndërtohet besimi i qytetarëve në institucionet dhe angazhimi i politikanëve për të mirën publike.

Bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën rekomandohen udhëzimet si vijon për avancimin e Kodit dhe Udhëzimit për zbatimin e Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve në Kuvendin e RMV-së:

- *Avancimi i Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve*

Bazuar në pasqyrën krahasuese të kodeve të disa vendeve, si dhe dokumenteve shoqëruese në formën e Udhëzimeve për zbatimin e kodeve, rekomandohet revidimi dhe plotësimi i Kodit të Sjelljes Etike të Deputetëve me fushat që aktualisht nuk janë të përfshira, ndërsa janë të rëndësishme për të siguruar qasje të plotë dhe koherente ndaj problematikës etike, si dhe zhvillimin e Udhëzimit krejtësisht të ri për zbatimin e Kodit sipas shembullit të praktikave më të mira ndërkombëtare.

- *Ngritja e standardeve të etikës dhe transparencës*

Që Kodi të ketë implikime dhe ndikime pozitive, është e nevojshme të forcohen dhe promovohen standardet e etikës dhe transparencës. Një nga masat e mundshme për forcimin e zbatimit të standardeve etike dhe transparencës së deputetëve është futja e deklaratave formale, publike të gjendjes pronësore dhe interesave, si dhe njoftimi publik i regjistrave të dhuratave dhe interesave të mbajtura nga Kuvendi që të jenë në dispozicion për publikun e gjerë. Në këtë mënyrë, do të kontribuojë në ndërtimin e besimit, sigurimin e publikut me qasje transparente në aktivitetet e deputetëve dhe Kuvendit, por edhe duke siguruar funksionimin e vazhdueshëm të mekanizmave për ndjekjen e punës së deputetëve nga sektori joqeveritar dhe organizatat civile që punojnë në këtë sferë.

- *Futja e mbikëqyrjes së pavarur të zbatimit*

Nga shembujt e shqyrtuar mund të konkludohet se praktika e futjes së mbikëqyrjes së pavarur të zbatimit të Kodit mund të jetë karakteristike thelbësore që do të ndikojë pozitivisht në zbatimin e plotë të Kodit. Lënia e deputetëve për të mbikëqyrur veten e rrit rrezikun e zbatimit jo të plotë, madje edhe shpërfilljen e plotë të Kodit, duke e shndërruar në mjet politik që minon seriozisht qëllimin dhe funksionin e vendosur të Kodit për të ndërtuar besimin e publikut. Sigurisht, me rëndësi të paçmueshme është mbikëqyrja e pavarur të jetë plotësisht kompatible dhe komplementare me elementët e tjerë të sistemit të integritetit. Rekomandohet që roli mbikëqyrës i zbatimit të Kodit të bazohet në qasjen holistike, përkatësisht të plotësohet edhe me përfshirjen e rregullt dhe pjesëmarrjen e publikut në ndjekjen, duke promovuar rolin e mediave si mbikëqyrës i punës së bartësve të funksioneve publike, si dhe qasjen gjithëpërfshirëse duke përdorur ekspertizën dhe kapacitetet e shoqërisë civile.





Pasqyrë e fushave të mbuluara nga Kodi i etikës						
	Fusha	Maqedonia e Veriut	Shqipëria	SHBA	BE	Britania e Madhe
1	<b>Parimet themelore</b>	Rregullat themelore të sjelljes së deputetëve (objektiviteti në sjellje pa paragjykime dhe diskriminim, respekt reciprok dhe respekt për integritetin personal të të tjerëve)	Parimet etike të përgjithshme dhe detyrat e deputetit. Sjellja në Kuvend (fjalor jo parlamentar dhe diskriminues, votim në emër të një personi tjetër, paraqitja e deputetit në aktivitetet parlamentare, abuzimi i reputacionit, sjellja gjatë seancave, sjellja ndaj kolegëve dhe shërbimeve, veshja, ndalimi i alkoolit dhe narkotikëve, ndalimi i ngacmimeve seksuale, orientimi dhe këshillimi i deputetit, ruajtja e informacionit të klasifikuar)	Standardet themelore etike (e mira publike dhe interesi publik, shkelja e parimeve dhe masave etike, sistemi (Komiteti), procedurat, besueshmëria, rregullat, standardet etike për ekzekutivin, kodi i etikës i shërbimit civil, rregullat për anëtarët, zyrtarët, mbikëqyrësit dhe komitetet, roli këshillues)	Parimet dhe detyrat udhëzuese të deputetëve në kryerjen e detyrave të tyre (referimi i dispozitave të ligjeve, rregullores së procedurës dhe kodit)	Parimet e përgjithshme dhe rregullat e sjelljes dhe respektimi i kodit (bujaria, integriteti, objektiviteti, përgjegjësia, ndershmëria, udhëheqja, sjellja e pritshme, vlerat themelore etike dhe zbatimi i kodit dhe shkelja e tij)
2	<b>Konflikti i interesit</b>	Konflikti i interesave (sjellja e ndërgjegjshme dhe e përgjegjshme, parandalimi i konfliktit të interesit publik dhe privat gjatë kryerjes së funksionit)	Konflikti i interesit (konflikt i përhershëm dhe i rastit i interesit, konstatim i një konflikti dhe veprim, regjistër i deklaratave, statusi i pronës dhe të hyrat)		Konflikti i interesit kur një deputet i Parlamentit Evropian ka një interes personal, hapat për të zgjidhur një konflikt interesi, zbulimi i të gjitha konflikteve reale ose të mundshme të interesit nga ana e deputetëve.	Konflikti i interesit (deklarata e interesit, kategorizimi i rasteve në të cilat kërkohet deklaratë)
3	<b>Punësim shtesë dhe të hyra të tjera</b>		Kufizimet gjatë kryerjes së mandatit (kryerja e një detyre tjetër shtetërore, kryerja e aktiviteteve fitimprurëse,	Punësim dhe të hyra shtesë (konflikt interesi, fitim personal, tarifa, bursa, donacione, ndalim i		Punësimi dhe fitim

			udhëheqje të organeve të menaxhimit, kryerja e veprimtarisë private, të hyra nga procedurat e tenderit, pronësi aktive, pozicion dominues në treg, aksione ose kapital, aksione në emër të një të afërmi të ngushtë)	përfaqësimit të personave të tjerë kur çështja përfshin Kuvendin, punësim i dyfishtë, ndalim i të hyrave nga qeveritë e huaja, negociata për punësim në të ardhmen, ndalim i anëtarësimit në bord për kompensim, të drejtat e autorit, kufizime vjetore të të hyrave shtesë të nëpunësve në shërbim, kufizime në post-punësim)		
4	<b>Ndalimi i korrupsionit</b>	Ndalimi i korrupsionit (veprim në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit, si dhe shmangia e situatave që mund të çojnë në dyshime të abuzimit)		Të hyrat dhe shpenzimet (financim nga llogaritë zyrtare, udhëtime zyrtare, pretendime të rreme dhe mashtrime, shpenzime postale)		Donacione dhe mbështetje tjetër për kryerjen e aktiviteteve në cilësinë e deputetit, donatorët e lejuar
4	<b>Dhurata</b>	Ndalim për marrje të dhuratave (vlera e dhuratave, pjesëmarrja në forume dhe seminare)	Dhurata dhe përfitime (aplikimi, dorëzimi, ruajtja e dhuratave, regjistri, vlera e dhuratës, përfitimet për aktivitetet jashtëparlamentare)	Dhurata (ndalimet themelore, rregulla, kategori dhe vlera e dhuratave, rregullat për anëtarët e familjes, bashkëshortët, fëmijët, lobistët, përfaqësuesit e huaj, dhuratat miqësore personale, pjesëmarrja në ngjarje, ngjarjet sportive, mbledhja e fondeve dhe ngjarjet e bamirësisë, sponsorizimet, fushatat, dhuratat nga qeveritë dhe organizatat e	Dhurata dhe përfitime të ngjashme (dhuratat e marra në cilësinë zyrtare, paraqitje, dorëzim, mbajtja, ruajtja, shfaqja, regjistrimi)	Dhuratat, përfitimet dhe shërbimet e hotelierisë nga burime në MB, vizita jashtë MB

				huaja, aktivitetet pro bono, çmimet dhe mirënjohjet, mundësi dhe përfitime të tjera, dhurata të papranueshme dhe kthimi i tyre, ryshfet, paraqitje)		
5	<b>Udhëtime</b>			<b>Udhëtime</b> ( <i>Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe qëllimi i udhëtimit, ndalimi i lobistëve që marrin pjesë në organizimin e udhëtimit, vizita zyrtare, udhëtime të paguara nga individë privatë, udhëtime në Shtetet e Bashkuara ose jashtë vendit, kohëzgjatja e udhëtimit, shoqëruesi, shpenzimet e postimit, dhuratë udhëtim nga një shok, udhëtime të paguara nga qeveria, nga një vend i huaj, nga një parti politike</i> )		
6	<b>Transparenca financiare</b>	Disiplina buxhetore dhe financiare (përdorimi i duhur i fondeve publike dhe pajisjeve të dhëna për përdorim)	Transparencë dhe konfidencialitet (Deklarata dhe kontrolli i pasurisë, shpallja e deklaratës, transparenca financiare)	Publikimi financiar (rregullat për transparencën financiare, përmbajtja e deklaratave - të ahyrat e jashtme dhe transaksionet e biznesit, pasuria, investimet, përgjegjësia për bashkëshortin dhe fëmijët, përfitime të tjera, dhurata, informacione mbi pozicionet jashtë-parlamentare, kontratat, fondet)	Deklarata e deputetëve për interesa financiarë	Interesi financiar (punësimi dhe të hyrat, donacionet e lejuara dhe regjistrimi, dhurata, përfitime dhe shërbime të hotelierisë në Mbretërinë e Bashkuar, vizitat jashtë MB, dhuratat dhe përfitimet nga burime jashtë MB-së, toka dhe prona, aksionet, anëtarët e familjes - punësimi)

7	<b>Sjellja ndaj mjetet e punës dhe sjellja gjatë fushatës</b>	Sjellja ndaj mjeteve që përdoren në Kuvend (përdorimi ekonomik i fondeve të vëna në dispozicion të)	Përdorim i burimeve dhe i personelit	<b>Fushata</b> (Përdorimi i duhur i fondeve dhe burimeve të fushatës dhe aktivitetet e lidhura me fushatën, ndalimi i përdorimit të ambienteve të Kuvendit dhe fondeve në fushatë, fushata jashtë orarit të punës, sjellja, përdorimi i fondeve të fushatës, udhëtimet, ndarja e aktiviteteve politike dhe zyrtare, rregullat për nëpunësit e kandiduar)		
8	<b>Rregullat për nëpunësit në shërbim</b>			Rregullat për nëpunësit në shërbim (diskriminimi, nepotizmi, punësimet, largimi nga puna, asistentët personalë, kompensimi, punësimi i praktikantëve, vullnetarët, konsulentët, lobistët, trajnimi minimal për etikë)		
9	<b>Kontakt dhe bashkëpunim me organizata të jashtme</b>			Organizata të jashtme (organizata zyrtare mbështetëse, organizata joformale, subjekte private me qëllime të përbashkëta, grupe këshillimore, konferenca dhe takime, kompensim për pjesëmarrje në ngjarje, sponsorizime)		
10	<b>Punë për një temë/projekt</b>		Aktiviteti i lejuar jashtëparlamentar i deputetit,	Detyra - Casework (komunikim joformal,		

			transparenca e projekteve me Kuvendin	mbështetës, prokurime dhe grante, komunikim me gjykata, qeveri të tjera, me parti joqeveritare, konfidencialiteti i informacionit, interesat personale, dhuratat dhe kompensimi, pozitat politike në qeveri, marrëdhëniet me sektorin privat)		
<b>11</b>	<b>Lobimi</b>		Lobimi në Kuvend dhe Regjistri i grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile (marrëdhëniet e deputetit me lobistët dhe organizatat e shoqërisë civile, transparenca e kontakteve të deputetëve me lobistët, njoftimi publik i takimeve me lobistët, marrëdhëniet deputet-lobist duhet të dokumentohen, dokumentet e shkruara publikohen zyrtarisht, lobimi në këmbim të pagesës është i ndaluar)	Kufizimet e lobimit. Ndalim për dhurata për lobim.		Lobimi (rregullat në lidhje me lobimin, afatet kohore, përkufizimet, aplikimi, anëtarët e familjes të përfshirë në lobim)
<b>12</b>	<b>Organi kompetent i Kuvendit</b>	Komisioni është përgjegjës për përcaktimin e shkeljeve dhe vendosjen e masave	Byroja e Kuvendit është organi kompetent për zbatimin e Kodit të sjelljes së deputetëve, Byroja e Kuvendit lëshon udhëzime të hollësishme për sjelljen në Kuvend	Roli i Kongresit dhe i Komitetit, historia dhe procedurat e Komitetit	Roli i Komitetit këshillimor për sjelljen e deputetëve	Shkarkimi i hetimeve: Komisioneri kuvendor për standardet, shkarkimi i hetimeve: Komiteti i standardeve, juridiksioni i Komisionerit kuvendor për standardet

13	<b>Masat</b>	Paralajmërimet për lëndime të lehta dhe paralajmërimet publike për lëndime të rënda publikohen në faqen e internetit të Kuvendit.	Kufizim i imunitetit (procedura disiplinore për shkeljen e kodit, masat, procedura)	Shkelja e standardeve etike	Procedura dhe zbatimimi në rast të shkeljeve të mundshme të Kodit të sjelljes (sigurimi i zbatimit të masave, monitorimi, kompetenca e Sekretarit të përgjithshëm)	Hetimet dhe masat (ankimimi, privilegji parlamentar, procedurat e hetimit)
----	--------------	---	---	-----------------------------	--	--